



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 30.11.2018,  
duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Genc Sherifi, Vala Peshku, Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Sami Boroci, Eman Rrahmani, Fadil Gashi dhe Egzon Azemi.

Mungoi: Blerand Stavileci.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Faton Ajeti, përfaqësues nga OSCE-ja, Qëndron Arifi përfaqësues nga INPO, Shemsedin Thaqi, përfaqësues nga Drejtoria e Pronës, OF1 Coppoa Giovanni (KFOR).

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Agim Kuleta, kryesues.

Para se të fillonin me diskutimin për rendin e ditës, Agim Kuleta, kryesues, tha se pika e gjashtë "Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Eko - Lagje", duhet të tërhiqet nga rendi i ditës, pasi që nuk është dërguar materiali. Dren Kukaj propozoi që të futet në rend dite edhe një pikë "Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë", për të cilën lëndë jemi duke punuar dhe do t'ua sjellim komplet materialin në mbledhjen e Kuvendit. Agim Gashi theksoi se duhet të sillet ndonjë shkresë, në mënyrë që të kemi formalisht një informatë për këtë.

Njëzëri u miratua ky

### RENDI I DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë

dhe Financa;

2. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Ali (Latif) Bekës;
3. Propozimvendimi për tatimin në pronën e paluajtshme;
4. Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit";
5. Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A 1, të lagjes "Dodona";
6. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë;
7. Propozimvendimi për lejimin e mjeteve financiare NPL "Sport Marketing";
8. Propozimvendimi për miratimin e Strategjisë së zhvillimit të turizmit në komunën e Prishtinës;
9. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Busi;
10. Të ndryshme.

**Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

Sami Boroci kërkoi që në faqen 8 të ekstraktit, të bëhet plotësimi i paraqitjes së diskutimit të tij. Vala Peshku theksoi se procesverbali po mbahet vetëm me shkrim, andaj bëri kërkesë që ai të incizohet.

Agim Kuleta, kryesues, tha se mbledhja incizohet, por është mirë me korigjuar në formulim dhe këtë konkrete me përmirësuar.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

**Pika e dytë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Ali (Latif) Bekës.**

Lidhur me këtë pikë sqarime dha Dren Kukaj, duke cekur se kjo është një lëndë, ku pala na ka paditur në gjykatë, dhe ne kemi arritur ujdj gjyqësore në raport me këtë pronë. Fjala është për një pronë publike, ku pala qëndron në pronë publike me shtëpi, ndërsa prona e tij private është rrugë dhe ne e këmbejmë në bazë të ujdisë gjyqësore.

Halim Halimi tha se materialin që e keni dërguar është në rregull, andaj është mirë të bëhet këmbimi.

**Agim Gashi** parashtrroi pyetje, se a pritet vlerësimi i pronave, sepse sipërfaqja e pronave nuk është e barabartë, ndërsa është e njëjta zonë, por dallimi është i madh.

**Dren Kukaj** u përgjigj, duke thënë se vlerësimi e barazon këtë.

**Agim Gashi** tha se pala i ka 727 m<sup>2</sup>, e ka uzurpuar krejt, dhe gjendja faktike e pamundëson heqjen e një pjese, atëherë çka bën Komuna, ku ja merr pjesën shtesë?

**Dren Kukaj** tha se neve na intereson së pari gjendja juridike. Nëse vlerësimi e nxjerr që një pjesë duhet me shkurtuar, atëherë një pjesë ne ia shkurtojmë, pastaj është çështje tjetër si merremi me të, nuk e paragjykon ajo procesin.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Ali (Latif) Bekës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e tretë**

**Propozimvendimi për tatimin në pronën e paluajtshme.**

**Shemsedin Thaqi**, përfaqësues nga Drejtoria e Pronës, dha sqarime, duke cekur se sa i përket tatimit në pronë, përmes këtij vendimi kemi vendosur që të rikonfirmohet baza tatimore ashtu siç ka qenë, nuk kemi ndryshuar asgjë, tash ka hyrë në fuqi Ligji, nga 2018-a, që tash e tutje të bëhet tatimi në tokë. Siç e dini, komunat i caktojnë vetëm normat tatimore, ndërsa vlerësimin e bën Ministria e Financave.

**Agim Gashi** pyeti se si e llogaritni vlerësimin në bazë të pronave, p.sh. kemi kategori të ndryshme, që shkon nga 1 deri 12, 13 kategori, pastaj konfiguracionet, përbërja e tokës, pyjet, llojet e pyjeve, kullosat etj. sipas kategorive, kush e vlerëson vlerën bazë të tokës? Ju e caktoni tatimin, por ju duhet ta keni vlerën bazë të tokës.

**Shemsedin Thaqi** tha se vlerësimin e bën Ministria e Financave, janë ekspertët e fushës së vlerësimit, janë të certifikuar, të dhënat i marrin prej Agjencionit Kadastral, vlerësimin e bëjnë në bazë të zonës, se cilës zonë i takon toka, ku secila fletë poseduese e ka zonën 1,2,3 etj. Pra, secila pronë ka me pasur një certifikatë të veten të vlerësimit dhe me atë certifikatë pala ka të drejtë ankese.

**Agim Gashi** tha se janë çështje të ndjeshme, se ju e keni parë as subvencionet nuk munden njerëzit me i fituar për shkak të kontesteve pronësore dhe mos rregullimit, thjeshtësimi të procedurave për bartjen e tokave nga trashëguesit realë.

**Shemsedin Thaqi** theksoi se ky është problem në tërë Kosovën, jo vetëm në Prishtinë.

**Agim Gashi** tha se vërehet që në procedura të bartjes pengohet parcelimi. Nëse unë e blej një pronë prej dikujt, një pjesë të asaj prone, Komuna ta mundëson vetëm regjistrimin në bartjen në bashkëpronësi dhe nuk lejon bartjen në emër tënd, d.m.th. pjesën me shkëputur nga ai, por vetëm ta lë në bashkëpronësi, me një numër të veçantë.

**Shemsedin Thaqi** tha se kjo është fushë e kadastrit, por mund të përgjigjem, se planet urbanistike i kanë kushtëzuar mos me u bërë parcelimi i shumë ngastrave.

**Sami Boroci** tha se para dy viteve kam pasur shumë ankesa nga banorët e Hajvalisë, ku për shkak të Fshatit Ndërkombëtar, aty është rritur tatimi në pronë edhe për banorët që jetojnë nën Fshatin Ndërkombëtar, e që janë me kushte jo të mira. Andaj, besoj se është jo korrekte që për shkak të Fshati Ndërkombëtar, tërë asaj lagjeje t'i rritet tatimi në pronë.

Ai pyeti se a ka ndonjë mundësi me u ndryshuar vlera e tatimit të Fshati Ndërkombëtar nga pjesa tjetër e lagjes.

**Shemsedin Thaqi** theksoi se rritja nuk është bërë sepse e kanë vendosur zyrtarët komunalë, por stafi politik e ka vendosur atë rritje. Më herët vlerësimi nuk është bërë real, e tash kur vlerësimi është bërë real, normal që iu ka rritur edhe tatimi në pronë, por iu ka dhënë mundësia secilit qytetar me parashtruar ankesë mbi vlerën e caktuar.

**Agim Gashi** tha se dokumentin që do ta kemi kur të bëhet vlerësimi, duhet të merren parasysh disa faktorë të shitjes ose kontratës së shitjes dhe të nxirret vlera mestarë e tregut, mirëpo si ka me pasur mundësi Komuna me i kontrolluar kontratat që bëhen me noterë, dhe ia ulin vlerën për shkak të këtyre gjërave dhe nuk e paraqesin gjendjen reale. Kjo është përditshmëri në tregun kosovar.

**Shemsedin Thaqi** theksoi se është praktikë, por janë krijuar zyra të vlerësimit dhe nga stafi ynë i kemi 5 vlerësues.

**Sami Boroci** pyeti se a i bashkëngjitet vlera e vlerësuesve, p.sh. e hipotekave dhe të ngjashme?

**Shemsedin Thaqi** tha se me Ligjin e ri, secila pronë ka me pasur certifikatën e vlerësimit, ku do të ceket sa është vlera dhe atë vlerë pala ka të drejt me kontestuar. Po ashtu, nuk merret gjithëherë për kriter kontrata, se kemi ne shumë kontrata që janë kontrata formale, jo reale, por ne i marrim ato që janë reale.

**Eman Rrahmani** parashtrroi pyetje, se a dallon edhe diferenca e arkëtimit nga viti i kaluar në tatimin në pronë, apo vetëm është realizuar 99 % e planifikimit për këtë vit. Kjo vlera që është arritur deri tash e të hyrave, sa është më i madh se vitin e kaluar, sa janë kryer të hyra?

**Shemsedin Thaqi** dha sqarime, duke cekur se në këtë periudhë nuk e kanë bërë krahasimin.

**Agim Gashi** pyeti se a keni mundësi me i përfshirë realisht të gjitha pronat për të cilat qytetarët janë të obliguar të paguajn.

**Shemsedin Thaqi**, lidhur me regjistrimin e pronave, bëri të ditur se afër 4000-5000 prona të reja regjistrohen në vit në Komunë të Prishtinës.

**Kryesuesi** konstatoi se u miratua Propozimvendimi për tatimin në pronën e paluajtshme dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e katërt**

**Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit".**

Sa i përket kësaj pike, **Genc Bashota** dha sqarime, duke cekur se në bazë të takimeve të shpeshta me Universitetin e Prishtinës, të cilët kanë nevojë për hapësira dhe kanë pasur çështjen edhe të Fakultetit të Shkencave Matematiko – Natyrore, aty ku janë e kanë shumë akute për me u zgjeruar. Aty nuk po bën për shkak të Planit dhe disa kontesteve pronësore, përfshirë edhe Fakultetin Ekonomik dhe disa fakulteteve të tjera. Pas një mori takimesh, është propozuar në këtë pjesën të Fakultetit Teknik, me hy me Plan rregullues për me i plotësuar nevojat e UP-së në atë hapësirë. Ata kanë ardhur me një propozim, por ne mendojmë se fillimisht duhet hartuar një plan rregullues për atë hapësirë që Universiteti me punuar, që ata vetë me punuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, pastaj me prezantuar në Kuvend për sistemimin e për nevojat e UP-së.

**Halim Halimi** tha se ekziston arsyeshmëria për këtë që tha drejtori, me u bërë Plan rregullues i hollësishëm për zonën e Fakultetit Teknik, në Lagjen “Bregu i Diellit”.

Në vazhdim ai parashtrroi këtë pyetje: Si po bëjnë plane rregulluese të hollësishme pa harta zonale? Është në procedurë, por nuk dihet, sepse tash e 5 vjet është në procedurë të hartimit, kështu që mos po gabojmë që po i hyjmë një plani rregullues të hollësishëm të kësaj zone pa hartë zonale.

**Genc Bashota** tha se te rasti “Dodona” e kemi përgjigjën e Ministrisë, e cila thotë: Me Udhëzimin e ri administrativë mundeni me bërë plane rregulluese të hollësishme, në harmoni me PZHK, pastaj inkorporohen në hartën zonale. D.m.th., na kanë dhënë një rrugë ligjore shumë të qartë. Ka qenë specifike për lagjen “Dodona” dhe vlen edhe për vendet tjera.

**Eman Rrahmani** tha se duke marrë parasysh që tash e një vit ka kaluar në Kuvend hartimi zonal dhe Plani zhvillimor, mendoj këto vetëm po e vonojnë këtë proces, e kjo dihet se nuk po keni kapacitete me i përfunduar ato, e jo me u zgjerua me plane tjera. Tash, ligjërisht kemi edhe 8 muaj afat për me përfunduar, në bazë të asaj që ka kaluar në Kuvend.

Pasi Ministria e paska dhënë dritën jeshile me u bërë plan i hollësishëm, po fillojmë edhe me të gjitha lagjet, si me lagjet “Kodra e Trimave”, “Kolovica”, “Bregu i Diellit”, për secilën. Nuk ka mundësi një pikë në “Bregun e Diellit”, një pikë atje, varësisht prej kërkesave qysh i kemi, e me u bllokuar qytetarët, ose po e pauzojmë hartimin zonal dhe Planin zhvillimor, le të merremi me Planin zhvillimor të hollësishëm për secilën lagje dhe ta zgjidhim problemin e tyre. Po ashtu, nuk na është paraqitur asnjë punë se çka është bërë deri tani lidhur me hartimin zonal dhe Planin zhvillimor, që janë shumë të rëndësishme për qytetin e Prishtinës, dhe për këtë a keni mundësi me na treguar se çka është punuar deri tash!

**Fadil Gashi** u shpreh i pajtimit me z. Rrahmani. Ministria e paska dhënë dritën jeshile për “Dodonën” për “Bregun e Diellit”, por nuk e ka dhënë për “Kolovicë”, atëherë pse vetëm për “Dodonë”?!

**Genc Bashota** theksoi se pyetja ka qenë specifike vetëm për “Dodonë”.

**Fadil Gashi** shprehu mendimin se, ose të shkohet me radhë me lagje, ose të mos shkohet fare. Nuk mund të bëjmë dallime mes lagjeve. Faktikisht, këto janë dallime, çka ka "Dodona" kundër "Bregut të Diellit", "Kodrës së Trimave" etj.!

**Genc Bashota** tha se në qytet i kemi disa probleme që janë më urgjente dhe më prioritare karshi të tjerave. Një prej problemeve në qytet është, ju e dini, prej qeverisjes së kaluar është problemi i lagjes "Dodona". Ky plan është miratuar tash e 2 vjet për me u hartuar, por nuk është hartuar, për shkak se parametrat kanë qenë në kundërshtim njëri me tjetrin te planet rregulluese, tash vetëm sa e kemi hapur një rrugë përpara.

**Fadil Gashi** u interesua se a ka ndonjë afat për t'u hartuar harta zonale, apo vetëm harta zonale mbas 3, 4 viteve, unë personalisht nuk e votoj këtë pikë.

**Genc Bashota** tha se ky është një projekt i madh, është projekt për gjithë Prishtinën, harta zonale e ka rrugën e vet dhe procesin e vet, dhe jemi me grupin duke punuar në këtë drejtim. Ne nuk jemi me ju dhënë juve llogari se çka jemi duke punuar. Kur të kryhet harta zonale, del në Kuvend, e shikoni, e votoni ose nuk e votoni.

**Eman Rrahmani** tha se në mbledhjen e fundit drejtori ka thënë se nuk kryhet harta zonale për 18 muaj.

**Genc Bashota** theksoi se nuk besoj që kryhet për 18 muaj dhe ende nuk janë bërë 18 muaj.

**Agim Gashi** tha se në vitin 2012, kurë është miratuar Ligji, e pati afatizuar se brenda cilit afat komunat janë të obliguara t'i nxjerrin hartat zonale. Tash është viti i pestë dhe nuk ka hartë zonale, ka qenë një afat i caktuar me ligj.

**Vala Peshku** tha se kur e kemi votuar buxhetin, e kemi paraparë kohën kur pritet të kryhet harta zonale, nëse nuk e kryejnë siç kanë thënë atëherë, prapë i pyesim pse nuk po e kryejnë, e jo me i paragjykuar tani prej një Plani rregullues për "Bregun e Diellit" me dalë te harta zonale. Drejtori shumë mirë po e shpjegon, se MPL e ka dhënë rrugën ligjore përmes Udhëzimit administrativ.

**Sami Boroci** u shpreh se me sa e kuptova drejtorin, ky udhëzim administrativ vlen pastaj edhe për aktet tjera, apo vlen vetëm për rastin "Dodona"?

**Genc Bashota** bëri të ditur se ai është lëshuar specifikisht vetëm për rastin "Dodona", ja ku është Zyra ligjore, nuk mund të vlejë një udhëzim vetëm për një lagje specifike! Po ashtu, tha se janë dy-tri raste që ne i kemi veçuar, sot janë këtu që i kemi paraqitur, Universitetin dhe "Dodonën" që duhet trajtuar, përndryshe Universitetin e bëjnë ata, ne nuk kemi kurrfarë pengese në humbje kohe me trajtimin e një plani të tillë rregullues, ka kush e bën, e prezantojnë para nesh.

**Sami Boroci**, sa i përket krahasimit për harta zonale, nuk u shpreh i pajtimit, sepse nuk duhet krahasuar me komuna tjera. Drejtorja dhe Komuna e ka një afat dhe po shpresoj se ka me ardhur harta zonale në atë afat, por nuk po e shoh të rrugës, tash p.sh. e kemi edhe Planin e mobilitetit, qe sa është duke u endur, që ende nuk është ardhur në Kuvend, vonimi i këtyre temave pak më të mëdha me ardhur në Kuvend nuk po më pëlqen më së shumti.

**Agim Gashi** tha se, së pari Ministria e ka shkelur Ligjin për planifikimin hapësinor, të cilin e ka miratuar Kuvendi i Kosovës dhe nuk është treguar përgjegjës karshi këtij ligji, sepse që 5 vjet Kosova nuk ka plan, nuk ka hartë zonale dhe, nën dy, meqenëse ai udhëzim administrativ i jep mundësi specifike të lejohet ndërhyrja në planet e hollësishme, atëherë Komuna ka bërë shkeljen e dytë, sepse ka sjellë propozime në Kuvend pa marrë pëlqimin paraprak të Ministrisë për secilin plan ku ka pasur me u futur në procedurë për ndryshime.

Po ashtu, tha se Ligji është mbi Udhëzimin administrativ, nuk është Udhëzimi administrativ mbi Ligjin.

**Fatos Dibra** dha sqarime, duke cekur se ligjërisht ka qenë e lejuar dhe është e lejuar edhe me Ligj për planifikim hapësinor, autoriteti përgjegjës për planifikim dhe menaxhimin hapësinor siguron që plani zhvillimor komunal dhe harta zonale e komunës, përfshin të gjitha planet rregulluese urbane dhe planet rregulluese të hollësishme të miratuara paraprakisht.

**Agim Gashi** tha se ne po flasim për fillimin e ndryshimeve dhe Ligji thotë harmonizoni me hartën zonale, e tash paska të drejtë!

**Halim Halimi** u shpreh se mirë e dini drejtor, që 4-5 vjet kemi marrë vendime në Kuvendin e Komunës për hartimin e planeve rregulluese të hollësishme, MMPH na i ka kthyer si të kundërligjshme, a është kjo, tash Udhëzimi administrativ, siç po thotë drejtori, qenka ai Udhëzim administrativ, por mos na leni me ndenjor duar kryq, pa punuar hartën zonale dhe pa u bërë harta zonale ne nuk mund të nxjerrim Plan rregullues të hollësishëm për tërë qytetin, për të gjitha lagjet. Këtë e paska marrë specifike drejtori, për këtë lagjen "Bregu i Diellit", kështu që merrni prej Ministrisë konfirmimin.

**Fatos Dibra** dha sqarime lidhur me këto çështje.

**Eman Rrahmani** u shpreh se, unë si problem që e ngrita, nuk e ngrita në aspektin juridik, por më shumë në aspektin moral, se jemi duke iu hyrë në hak shumicës së lagjeve. Edhe në mbledhjen e kaluar, kur ishte propozimi për rirregullimin e Planit për një lagje tjetër "Prishtina e Re, zona Lindje", e pata të njëjtin reagim. Këtu po vini me kërkesa dhe ju si po i keni raportet me ata që po i bëjnë kërkesat dhe po i sillni si lëndë. Ne po kërkojmë që secila lagje ose të përfundohet, të hiqen të gjitha ato pika, të fillojmë punën seriozisht me hartimin zonal dhe Planin Zhvillimor dhe përfundohet për krejt Prishtinën, në mënyrë që Prishtina ta ketë të zgjidhur këtë problem e të mos diskriminohen. Unë seriozisht po them, jeni duke më detyruar krejt qytetarët e lagjes "Kodrës së Trimave" me i sjellë këtu, nëse ndodh kjo, dhe cilido plan rregullues që kalon dhe nuk kalojnë lagjet tjera.

**Genc Bashota** theksoi se lagja "Dodona" është miratuar në vitin 2016 në Kuvend. Ky plan rregullues, nuk është diçka që po e paraqes për herë të parë, si ekzekutiv unë nuk i qes, Kryetari i propozon, bashkë me kryesuesin, e qesin në Kuvend, e juaja është me vendosur a me votuar apo mos me e votuar, u tregojmë banorëve të lagjes "Dodona" që Kuvendi nuk donë ta votojë.

**Egzon Azemi**, rreth Planit rregullues për Fakultetin Teknik, tha se unë kisha propozuar me e hequr këtë pikë njëherë, se kam pasur kërkesa prej banorëve paraprakisht para se me pa materialin, d.m.th. gjatë këtij muaji edhe studentë të Fakultetit të UP-së dhe banorët po dëshirojnë me mbajtur një diskutim publik, ku do të diskutohej edhe plani për atë zonë.

**Genc Bashota** tha se kjo është që e përfshin edhe diskutimin publik.

**Egzon Azemi** tha që të mbahet edhe diskutimi publik paraprakisht, pse nuk mundet mu bërë?!

**Genc Bashota** tha se e ke gabim në hapa, d.m.th. se nuk mundet me bërë diskutim për asgjë, bëhet propozimi dhe hyn në diskutim publik.

**Egzon Azemi** shprehu mendimin se pasi nuk kanë nevojë me mbajtur diskutim publik, është mirë me i ftuar një ditë së paku disa përfaqësues të tyre, me u takuar me ta dhe me diskutuar për hallet dhe brengat e tyre. Pajtohem me komentet e Emanit dhe Fadilit, që sinqerisht po bëhet njëfarë loje, padrejtësie, sepse po bëhet njëfarë selektimi se ku me u bërë planet, cilat prona me u shkëmbyer, dhe shumë qytetarë po pësojnë pasi që nuk kanë lidhje. Kjo nuk është që nuk po kuptohet pse po bohet, besoni se po vërehen edhe emrat dhe mbiemrat, krejt shikimi po është kështu, kush është dhe çfarë interesi ka, a është ndërtim njëjtë si shtrirja e rrjetit të Termokosit që është bërë.

Çka është duke ndodhur me shtrirjen e rrjetit të Termokosit, me çfarë planifikimi?!

**Genc Bashota** tha se, çka është duke ndodhur, është pyetje, mirëpo nuk mundesh me më akuzuar ashtu pa lidhje, që unë jam ndërmjetësues në shtrimin e rrjetit të Termokosit, nuk ta jap të drejtën. Unë veç po të sugjeroj, kujdesu si po flet.

Po ashtu, tha se sa i përket pikës së gjashtë "**Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Eko - Lagje"**", këtë pikë e tërhiqem, për arsye se nuk është në rregull me PZHK, në ndërkohë e kemi parë, duhet prapë me pyetur Ministrinë se si me vepruar.

**Eman Rrahmani** propozoi që kjo pikë të tërhiqet dhe të gjitha pikat që kanë të bëjnë me planet rregulluese, të përfundohet hartimi zonal dhe Plani zhvillimor që i zgjidhin krejt problemet e qytetarëve.

**Agim Kuleta**, kryesues, tha se ti propozove me e tërhequr pikën, por a pranon kryetari me tërhiq ajo jo!

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin për me i propozuar kryetarit që ta tërheq pikën "**Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit"**".

Kryesuesi konstatoi se me 5 vota për dhe 4 vota kundër u miratua që me i propozuar kryetarit me tërhequr pikën **Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit"**.



**Pika e pestë**

**Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A 1, të lagjes "Dodona".**

**Eman Rrahmani** edhe për këtë pikë propozoi të tërhiqet.

**Agim Kuleta, kryesues,** lidhur me lagjen "Dodona", pyeti se a ka diçka specifike prej Ministrisë, a kemi përgjigje se është lejuar.

**Genc Bashota** theksoi se të gjitha dokumentet janë të bashkëngjitura, edhe të Ministrisë.

**Fatos Dibra** dha sqarime edhe për rastin "Dodona", se përgjigja e Ministrisë është e përgjithshme, thotë se Komuna harton plane rregulluese të hollësishme duke iu referuar Ligjit për planifikim hapësinor, neni 11, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2.

**Eman Rrahmani** theksoi se nuk është problemi te Ligji, por problemi parësor është problemi i lagjeve.

**Agim Gashi** parashtrroi pyetje, se kur Ministria i ka anuluar vendimet e Kuvendit lidhur me këto ndryshimet, i ka kthyer të paligjshme, këtu po thotë në bazë të Ligjit duhet me dërguar raportin e arsyeshmërisë. Ndoshta me i pas dërguar raportet e arsyeshmërisë nuk i kishin kthyer, edhe pse kjo pastaj len njëfarë dileme, Komuna e dërgon raportin e arsyeshmërisë, mirëpo varet a e pranon Ministria. Kjo nuk është siç po thua ti, Zyra ligjore blanko.

**Fatos Dibra** dha përgjigje, duke cekur se Raporti i arsyeshmërisë nuk duhet me u dërguar paraprakisht në Ministri, raporti dërgohet me Vendimin për fillim të hartimit të Planit, se nuk ka plan ende. Ministria e ka vërtetuar se ka qenë gabim në këtë pjesë, edhe në atë kohë, se tash thotë Komuna i harton në bazë të kësaj. Sa i përket aspektit ligjor, këto janë të ligjshme dhe tash në përgjigje të Ministrisë e ke të përgjithshme.

**Egzon Azemi** pyeti se cili është kriteri që po përzgjidhen këto plane rregulluese.

**Genc Bashota** tha se sa i përket kriterit, Plani është i miratuar në vitin 2016, d.m.th. inicimi i hartimit të Planit rregullues, ne kemi kërkuar sqarim prej Ministrisë, se ka konflikt në mes të PZHU-së dhe Planit rregullues, dhe sqarimi i Ministrisë është, thotë se tash kanë ndërruar rrethanat, sepse ka dalë një udhëzim i ri administrativ, në bazë të të cilit duhet përshtatur Planit zhvillimor komunal dhe normave teknike të planifikimit, dhe shumë mirë e shpjegon se duhet me i bërë në bazë të Udhëzimit të ri administrativ. Ky është shpjegimi i Ministrisë, mirëpo e juaja është me votuar apo mos me votuar.

**Eman Rrahmani** tha se ky po shkon prapë në hartim, jo në miratim.

**Halim Halimi** u shpreh se është mirë që këto vendimet e Kuvendit që i dërgojmë në Ministri, me ditur se a po kthehen të ligjshme apo të paligjshme.

**Fatos Dibra**, sa i përket mbledhjes së fundit të Kuvendit, tha se nuk na janë kthyer brenda 15 ditësh, por në ditën e 17-të, Komuna i ka publikuar dy ditë pasi ka kaluar afati, edhe pse kam komunikuar me zyrtarin përgjegjës në MAPL, i cili ka thënë se të gjitha janë kthyer të ligjshme, por kanë mbetur me u nënshkruar te sekretari.

**Osman Bllaca** i tha zotëri Halimit se ti po dëshiron gjithëherë, çdo konfirmim të Ministrisë me ta dërguar.

**Halim Halimi** kërkoi që çdo herë me material të silltet edhe konfirmimi i Ministrisë.

**Agim Kuleta, kryesues,** tha se më parë thatë se është specifikuar për "Dodonë" pëlqimi prej Ministrisë, dua me pasur të qartë për vete, d.m.th. për "Dodonën" është pëlqimi. **Genc Bashota** theksoi se materiali është komplet, duke përfshirë edhe përgjigjen e Ministrisë. **Eman Rrahmani** bëri të ditur se qëndrimi i tij është me e tërhequr ashtu si pikën tjetër dhe të fillohet me punën e hartimit zonal dhe Planit zhvillimor.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin për t'i propozuar kryetarit që ta bëjë tërheqjen e pikës "Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A 1, të lagjes "Dodona".

Kryesuesi konstatoi se më 5 vota për dhe 4 vota kundër u miratua, që t'i propozohet kryetarit tërheqja e Propozimvendimit për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A 1, të lagjes "Dodona".

**Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë.**

**Dren Kukaj** theksoi se për këtë pikë materialin nuk e kam me vete, vetëm propozimvendimin e kam si dokument. Nuk po e di tash formën e renditjes së pikave, se ka mundësi që të vije ambasadori, i cili dëshiron ta mbajë një fjalë rasti, kështu kanë thënë.

**Agim Kuleta, kryesues,** tha se në seancë e shikojmë për renditje dhe e ndryshojmë, e qesim më lart.

**Vala Peshku** tha se nuk e ndryshojmë në seancë, e shtim si pikë në rend dite dhe ia tregojmë kohën përafërsisht ambasadorit se kur mund të vijë.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për lejjimin e mjeteve financiare NPL "Sport Marketing".**

**Eman Rrahmani** kërkoi sqarime lidhur me këtë pikë.

**Osman Bllaca** tha se kjo pikë ka ardhur nga kryetari, është kërkesë e NPL "Sport Marketing", ata janë në telashe të mëdha financiare, se i kanë vetëm dy burime, prej Pishës së Gërmisë dhe Shtëpisë së Gurit në Brezovicë. Siç e dimë, vera ka qenë me të reshura të shiut dhe vetëm 22 ditë gjatë sezonit ka punuar Pishina dhe ka marrë shumë pak mjete, sepse ka qenë numri i vogël i pushuesve. Ndërsa Shtëpinë e Gurit e ka mbyllur Komuna e Shtërpcës, për shkak se është në territorin e tyre, që i bie se ata nuk kanë të hyra deri në qershorin e vitit të ardhshëm.

**Agim Gashi** tha se Shtëpia e Gurit është mbyllur qe 5 vjet, Komuna e Prishtinës nuk është interesuar fare për Shtëpinë e Gurit, sa që e ka sabotuar dhe shantazhuar përmes pjesëmarrjes së fëmijëve me Shkollën e Skijimit dhe kompania nuk është përkrahur asnjëherë, për shkak se drejtori ka qenë i një partie tjetër. Komuna e Shtërpcës nuk ka të drejtë me e mbyllur, mundet Inspeksioni i Komunës së Shtërpcës për shkak të kushteve të këqija, papastërtisë, pasigurisë teknike të objektit dhe kushteve të tjera që specifikohen me standardet, dhe ato i vlerëson inspeksioni përkatës. Nëse është bërë mbyllja për këto kushte, unë pajtohem, mirëpo nuk pajtohem me thënë e ka mbyllur Komuna e Shtërpcës, se fajet i kemi ne, se ajo është pronë e Komunës së Prishtinës dhe në territorin e Republikës së Kosovës. Andaj, duhet me bërë vlerësimin real pse është mbyllur dhe realisht me pasur kopjen e dokumentit pse është mbyllur, me ndërmarr masa, me e rinovuar objektin, me krijuar kushte për akomodimin e fëmijëve në sezonin e dimrit në Shkollën e Skijimit, sepse është pronë me shumë vlerë dhe shkollë me shumë interes publik. Unë në parim pajtohem me përkrahur ndërmarrjen.

**Eman Rrahmani** tha se ajo që u prezantua nga Osmani dhe ajo çka thotë, është pak në kundërshtim, për shkak se këto janë borxhe të vjetra, pagat e shërbimeve të vitit 2014 - 2016, nuk janë të kësaj periudhe tash që i keni 2016 - 2017, dhe i ke vetëm për 2 muaj 2018. Posaçërisht, bordin e keni prej 2011, 2012, 2013, 2014, 2016 dhe ke obligime në ujësjellës. Kërkojnë shumë prej 1785 € për inventarizim të Shkollës së Skijimit. Ju thatë se shkolla është e mbyllur prej komunës tjetër. Unë kisha propozuar me iu kërkuar që të na dërgojnë një plan të veprimtarisë, ku ata paraqesin një plan për programin e tyre se si kanë me vepruar në vitin 2019, në njëfarë mënyre me na siguruar se kanë me vazhduar, së paku shpenzimet e veta kanë me i mbuluar, se në çoftë se ne ju japim 130.000 €, prapë në vitin e ardhshëm ka me na u dashur me ndarë mjete për këtë kompani, sepse nuk hyjnë të hyra dhe nuk del pozitive, dhe nuk e di edhe sa ia vlen edhe me u mbajtur si kompani.

**Osman Bllaca** tha se është ndër ndërmarrjet më të dobëta në Komunën e Prishtinës.

**Sami Boroci** tha se jam për me bërë të mundshmen me shpëtuar këtë ndërmarrje. Sa i përket planit të biznesit, unë pajtohem me Emanin jo vetëm për "Sport Marketigun", por ne duhet si Kuvend deri sa të votojmë një subvencion të tillë, duhet me i ditur objektivat, planin e asaj se si kanë me i mbuluar shpenzimet e veta për këtë ndërmarrje. Pajtohem plotësisht me ju drejtuar kryeshefes, kryetari apo kryesuesi, me e sjellë një arsyetim më të mirë për seancën e Kuvendit. Unë e përkrah këtë propozim.

**Vala Peshku** pyeti se a janë duke dashur me aktivizuar Shtëpinë e Gurit, meqenëse po kërkojnë mjete për me i bërë shtretër të mirë. Po ashtu, a kanë paraqitur ndonjë plan për këtë rregullimin e këtyre nyjave sanitare, ata duhet me e sjellë, se po dihet se obligimet e sezonit dimëror në Shtëpinë e Gurit janë nevojat për investime dhe ndërhyrje në renovime gjeneral të objektit, ndërsa mjete kanë kërkuar vetëm për dyshekë, batanije, jastëk, mbulesa, ndërsa a kanë mjete për pjesët tjera të rregullimit, apo nuk dëshirojnë me investuar në nyjat sanitare gjatë këtij viti.

**Osman Bllaca** tha se sa e di unë, përafërsisht janë 60 € që i kanë llogaritur.

**Egzon Azemi** paraqiti qëndrimin se në parim janë për me votuar këtë subvencion, me kërkesat që i ceku Emami, dhe tjetra duhet me pasur informacione, sepse Komuna e Shtërpcës ka krijuar komision dhe si qëllim e ka investimin në atë shtëpi. Pra, Komuna e Shtërpcës është duke e trajtuar atë si pronë të Komunës së vetë atë shtëpi, kështu që ne po e ndajmë një buxhet, pa e ditur konkretisht çka ka me u investuar aty. Duhet të bëhet një arsyetim më i mirë deri në

seancën e radhës, ta dimë ne çka ka ndodhur, a duhet me paditur Komunën e Shtërpcës ndaj kësaj qasje që po bën ndaj këtij objekti dhe cilët duhet me qenë hapat si Komunë me i ndërmarr për ndarjen e buxhetit.

**Genc Sherifi** u shpreh i pajtimit me Egzonin, se është mirë ma ardhur ndonjë përfaqësues nga ndërmarrja "Sport Marketing", me na shpjeguar çka ndodhur me këto mjete, ku shkojnë, çka ndodh me Shtëpinë e Gurit, me Pishinën e Gërmisë, sa ka të hyra në vit, me pasur një informacion si Kuvend me ditur çka po dëshirojnë, besoj se është më korrekte për të gjithë.

Kryesuesi e hodhi në votim **Propozimvendimin për lejimin e mjeteve financiare NPL "Sport Marketing"**.

Kryesuesi konstatoi se u miratua **Propozimvendimi për lejimin e mjeteve financiare NPL "Sport Marketing"**, me propozimet e dhëna, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e tetë**

**Propozimvendimi për miratimin e Strategjisë së zhvillimit të turizmit në komunën e Prishtinës.**

Kryesuesi konstatoi se u miratua **Propozimvendimi për miratimin e Strategjisë së zhvillimit të turizmit në komunën e Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e nëntë**

**Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Busi;**

Kryesuesi konstatoi se u miratua **Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Busi dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Të ndryshme**

**Eman Rrahmani** propozoi që si pikë të rendit të ditës me e futur diskutimin mbi punën e deritashme të qeverisjes në Prishtinë, ekzekutivit, punën njëvjeçare.

**Agim Kuleta**, kryesues, bëri të ditur se Raport i Kryetarit vjen më vonë.

**Mbledhja përfundoi në orën 11:30.**

**Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit  
Agim Kuleta**



Faqe 12 nga 12